



Në mbështetje të Nenit 12, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9, të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 10.02.2025, nxjerr:

## **RREGULLORE 01/2025**

### **PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË DEKLARIMIT TË PASURISË NGA AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

#### **Neni 1**

##### **Objekti**

1. Rregullorja për procedurën e verifikimit dhe kontrollit të pasurisë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), përcakton rregulla dhe procedura lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë të subjekteve deklaruese, sa i përket vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave të deklaruara sipas Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, si dhe papajtueshmëritë e funksioneve sipas Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.
2. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore janë në harmoni me Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, si dhe njësitë tjera përgjegjëse të Agjencisë, të cilat përfshihen në procesin e verifikimit dhe kontrollit të deklarimeve të pasurisë të subjekteve deklaruese.

#### **Neni 3**

##### **Formulari i deklarimit të pasurisë**

1. Formulari elektronik për deklarimin e pasurisë, përmban të dhënat si në vijim:
  - 1.1. të dhënat personale për subjektin deklarues: emri dhe mbiemri (emri i prindit), numri personal, gjinia, data e lindjes, vendi i lindjes, adresa e përkohshme e banimit, adresa e përhershme e banimit, statusi i gjendjes civile, e-mail adresa,

numri i telefonit të kontaktit fiks/mobil, si dhe numri fiskal kurdo që është e mundur.

- 1.2. të dhënat për funksionin deklarues dhe funksionet ose angazhimet tjera të subjektit deklarues, si në vijim: emri i institucionit, lloji i institucionit, adresa e institucionit, komuna, njësia organizative, funksioni, niveli i funksionit (pozitës), data e emërimi/fillimit, data e përfundimit/largimit.
- 1.3. të dhënat personale për anëtarët e tjerë të familjes me të cilët subjekti deklarues jeton në bashkësi familjare, bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor, prindërit dhe fëmijët, si në vijim: emri dhe mbiemri, data e lindjes, numri personal, gjinia, statusi dhe lidhja me subjektin deklarues.
- 1.4. të dhëna për pasuritë e paluajtshme si: lloji i pasurisë, sipërfaqja, adresa, komuna, prejardhja, origjina/përfitimi, numri i parcelës/njesisë identifikuese, viti i përfitimit, vlera/çmimi, pronësia, dhe pronari paraprak.
- 1.5. të dhëna për pasuritë e luajtshme si: pasuri mbi vlerën mbi tremijë (3000) euro, lloji i pasurisë, modeli, prejardhja, origjina/përfitimi, përcaktimi i pjesëve të veçanta, viti i përfitimit, vlera/çmimi, pronësia, dhe pronari paraprak.
- 1.6. të dhëna për aksionet në shoqëri tregtare si: lloji, emri, numri i biznesit, shteti, përqindja e aksioneve, kapitali në euro, data e regjistrimit, data e përfitimit, dhe poseduesi/pronësia e aksioneve.
- 1.7. të dhëna për letrat me vlerë si: sasia, vlera në euro, prejardhja, data e pranimit, dhe zotëruesi i letrave me vlerë.
- 1.8. të dhëna për kriptovalutat/kriptoasetet si: emri i valutës/asetit, vlera e tanishme në euro, vlera e blerjes, sasia, prejardhja, data e përfitimit, poseduesi.
- 1.9. të dhëna për para të gatshme në llogari rrjedhëse, depozita dhe huadhënie si: lloji, emri i institucionit financiar ose personit fizik, vendi, shuma në euro ose në valutë tjetër, prejardhja, lloji i llogarisë, dhe zotëruesi.
- 1.10. të dhëna për të drejtat dhe detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizik si: kreditori/debitori, qëllimi i detyrimit, data e fillimit, data e mbarimit, kohëzgjatja, vlera fillestare, vlera aktuale, shuma totale, dhe detyruesi ndaj këtyre obligimeve.
- 1.11. të dhëna për donacionet në parti politike si: lloji, partia politike, shuma e donacionit, emërtimi, qëllimi, data, si dhe dhuruesi (Deklaruesi, Bashkëshorti ose fëmija).
- 1.12. të dhëna për donacionet dhe shpenzimet si: lloji i donacionit/shpenzimit, shuma në euro, emërtimi, qëllimi, data, dhënë si/shpenzuesi.

- 1.13. të dhëna për të ardhurat personale nga paga, pjesë marrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjellë të ardhura, si: lloji i të hyrës, prejardhja, vendi, institucioni financiar, dhe shuma.
  - 1.14. të dhëna për të ardhurat e familjarëve të subjektit deklarues si: lloji i të hyrës, prejardhja, vendi, institucioni financiar, dhe shuma.
  - 1.15. të dhëna tjera të cilat përfshijnë çdo të dhënë tjetër që subjekti deklarues nuk mund të përfshijë në pikat 1.1 deri në 1.14 të këtij Neni.
2. Formularët e deklarimit të pasurisë deri në vitin 2023, që janë pranuar nga Agjencia në formë fizike, dhe përmbajtja e tyre është përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi në kohën e dorëzimit të tyre.
  3. Formularët si në paragrafin 2 të këtij Neni mirëmbahen nga Agjencia dhe përdoren për qëllime verifikimi.

#### **Neni 4**

##### **Llojet e deklarimit të pasurisë dhe afatet**

1. Deklarimi i pasurisë nga subjektet deklaruese bëhet sipas llojeve si në vijim:
  - 1.1. deklarimi me marrje të detyrës, i cili përmban të dhënat e gjendjes aktuale në momentin e marrjes së detyrës zyrtare;
  - 1.2. deklarimi i rregullt vjetor, i cili përmban të dhënat për vitin paraprak 01 janar deri me 31 dhjetor;
  - 1.3. deklarimi me përfundimin e funksionit publik, i cili përmban të dhënat për periudhën e mbetur nga deklarimi i fundit;
2. Për qëllime të kontrollit sipas llojeve të deklarimit, kontrolli zhvillohet për periudhat si në vijim:
  - 2.1. vërtetësia ose saktësia e të dhënave të gjendjes aktuale në rastin e llojit të deklarimit sipas par.1, pika 1.1 të kësaj Neni.
  - 2.2. vërtetësia ose saktësia e të dhënave për periudhën e përcaktuar në rastin e llojit të deklarimit sipas par.1, pika 1.2 të kësaj Neni; si dhe
  - 2.3. vërtetësia ose saktësia e të dhënave të fundit në rastin e llojit të deklarimit sipas par.1, pika 1.3 të kësaj Neni;

#### **Neni 5**

##### **Përzgjedhja e subjekteve deklaruese për kontroll të plotë**

1. Pas përfundimit të afatit kohor për korrigjim të deklarimit të pasurisë, Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, fillon procesin e kontrollit të plotë.

2. Drejtori i Departamentit për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, në koordinim me Divizionin për E-shërbime dhe Sisteme, ndërmerr veprimet e nevojshme për përcaktimin e subjekteve deklaruese për kontroll të plotë si në vijim:
  - 2.1. subjektet deklaruese për kontroll të plotë sipas Ligjit nr. 08/L-108, Nenit 4, nën-paragrafi 1.1 deri 1.18 të ligjit, do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë çdo vit. Në vitet vijuese kjo kategori e subjekteve do t'i nënshtrohet kontrollit të plotë vetëm nëse ndryshimi në ndonjërin nga llojet e pasurisë së deklaruar është 25000 Eurosh e më shumë.
  - 2.2. përjashtimisht vlera e përcaktuar si në pikën 2.1 të këtij Neni, për subjektet deklaruese të kategorisë së lartcekur, Agjencia mund të vlerësojë dhe mund të mos merret për bazë vlera e theksuar, duke marrë parasysh rrethanat tjera të cilat mund të jenë potencial për vlerësim të rrezikut.
  - 2.3. subjektet deklaruese sipas Nenit 4, nën-paragrafi 1.19 deri 1.38 të ligjit, 1/3 e tyre përzgjidhen në mënyrë të rastësishme nga vet sistemi për kontroll të plotë. Në vitin vijues përzgjidhen 1/3 e pjesës së mbetur të subjekteve deklaruese në mënyrë të rastësishme nga vet sistemi për kontroll të plotë. Si dhe 1/3 e pjesës së mbetur nga kjo kategori e subjekteve deklaruese i nënshtrohen kontrollit të plotë.
  - 2.4. subjektet deklaruese sipas Nenit 5 të Ligjit nr. 08/L-108 i nënshtrohen kontrollit të plotë çdo vit, deri në 500 subjekte. Përzgjedhja bëhet në mënyrë të rastësishme nga vet sistemi, ndërsa numrin për kontroll të plotë nga kjo kategori e përcakton Drejtori i Departamentit për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.
3. Kontrollit të plotë mund t'i nënshtrohen edhe subjektet deklaruese të cilët nuk janë pjesë e listave përzgjedhëse, bazuar në informacionet e pranuar pas vlerësimit nga Departamenti përkatës.
4. Pas pranimit të kërkesës për korrigjim nga ana e subjektit deklarues, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit aprovon kërkesën për qasje në sistem vetëm njëherë brenda këtij afati.

## **Neni 6**

### **Procedimi i rasteve për kontroll të plotë**

1. Pas përzgjedhjes së subjekteve deklaruese për kontroll të plotë, lista e përgjithshme protokollohet, dhe shërben vetëm për nevoja të brendshme të Agjencisë.
2. Drejtori i Departamentit për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, merr Vendim për ndarjen proporcionale të rasteve për zyrtarët përgjegjës brenda Departamentit, për zhvillimin e procedurës së kontrollit të plotë.

3. Caktimi i rasteve për secilin zyrtar përgjegjës bëhet nga Drejtori i Departamentit në bashkëpunim me Udhëheqësin e Divizionit, përmes sistemit elektronik DMSA-CMS.
4. Në rast të konfliktit të mundshëm të interesit lidhur me rastin, zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë refuzimin e rastit në sistem me arsyetim, dhe njofton mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe Drejtorin e Departamentit. Në të gjitha rastet tjera, konfirmon pranimin e rasteve.
5. Në rastet kur një subjekt deklarues, është pjesë e kontrollit të plotë si rezultat i informacioneve të pranuara, dhe në të njëjtën kohë është përzgjedh nga sistemi në kuadër të listës së përgjithshme, i njëjti bartet tek zyrtari përgjegjës i cili paraprkasht ka filluar shqyrtimin dhe trajtimin e rastit.
6. Në raste të caktuara, Drejtori i Departamentit varësisht nga specifikat e rastit mund të vendos ndryshe për ndarjen e rastit tek zyrtari përgjegjës.
7. Në rastet kur zyrtarët e Agjencisë janë pjesë e kontrollit të plotë sipas listës së përgjithshme, të njëjtat barten për shqyrtim në Komisionin përkatës në Kuvend për mbikëqyrjen e Agjencisë.
8. Zyrtari përgjegjës gjatë zhvillimit të procedurës do të bashkëpunojë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, pa e cenuar pavarësinë profesionale në epilogun e rastit.
9. Pas përfundimit të procedurës së rastit, zyrtari përgjegjës e përmbyll rastin me raport përfundimtar, i cili dërgohet përmes sistemit DMSA-CMS tek udhëheqësi i drejtpërdrejtë për aprovim.
10. Rastet e përfunduara nga zyrtarët, udhëheqësi i drejtpërdrejt i aprovon ose i refuzon. Për rastet e refuzimit përmes DMSA-CMS, njoftohet Drejtori i Departamentit.
11. Drejtori Departamentit i aprovon ose i refuzon rastet e pranuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.
12. Në rastet kur udhëheqësi i divizionit është zyrtar përgjegjës i lëndës, rasti aprovohet nga Drejtori i Departamentit.
13. Për rastet e raportuara nga jashtë me dyshime për pasaktësi në deklarin e pasurisë, Agjencia trajton vetëm pretendimin e raportuesit, ndërsa në të gjitha rastet tjera zbaton verifikimin dhe kontrollin e plotë të pasurisë.

## **Neni 7**

### **Fillimi i procedurës së kontrollit të plotë**

1. Zyrtari përgjegjës pas pranimin të rastit, analizon, vlerëson dhe krahason të dhënat e formularit aktual të subjektit deklarues me të dhënat e deklaruara në formularin e vitit paraprak, nëse ka qenë subjekt deklarues.

2. Zyrtari përgjegjës fillon kontrollin e plotë duke kërkuar nga institucionet kompetente publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare, të dhëna elektronike, raporte, dokumente, dëshmi apo çdo informacion tjetër që i shërben procedurës rreth saktësisë dhe vërtetësisë së pasurisë së deklaruar të subjektit deklarues dhe anëtarëve të familjes, si në vijim:
- 2.1. të dhëna për funksionin deklarues dhe funksionet ose angazhimet tjera, nga institucioni ku subjekti deklarues ushtron funksionin apo angazhimin tjetër, si dhe institucionet tjera p.sh. Administrata Tatimore e Kosovës, Trusti Pensional i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; etj;
  - 2.2. të dhëna personale për subjektin deklarues dhe anëtarët e tjerë të familjes, nga Agjencia për Regjistrimin Civil;
  - 2.3. të dhëna për pasuritë e paluajtshme nga Agjencia Kadastrale e Pronës, Departamenti për Tatim në Pronë në Ministrinë e Financave, si dhe institucionet tjera;
  - 2.4. të dhëna për pasuritë e luajtshme, nga Agjencia për Regjistrim Civil-Regjistri i veturave si dhe institucionet tjera publike dhe private;
  - 2.5. të dhëna për aksionet në shoqëri tregtare, nga Agjencia e Regjistrimit të Biznesit, Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe Departamenti për regjistrimin e organizatave joqeveritare në ministrinë përkatëse;
  - 2.6. të dhëna për letrat me vlerë, nga Thesari i Kosovës, si dhe institucionet tjera publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare;
  - 2.7. të dhëna për verifikim për kriptovalutat/kriptoasetet nga subjekti deklarues;
  - 2.8. të dhëna për para të gatshme në llogari rrjedhëse, depozita dhe huadhënie, nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, Trusti Pensional i Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, institucionet financiare, si dhe institucionet tjera publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare;
  - 2.9. të dhëna për të drejtat dhe detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë, nga institucionet financiare-bankat si dhe institucionet mikrofinanciare;
  - 2.10. të dhëna për donacione në parti politike, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si dhe subjekteve politike;
  - 2.11. të dhëna për donacione dhe shpenzime, nga institucionet publike dhe private;
  - 2.12. të dhëna për të ardhurat personale, nga paga, pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjellë të ardhura për subjektin deklarues dhe anëtarëve të familjes, nga Ministria e Financave, Trusti Pensional i Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe institucionet tjera publike dhe private;

3. Verifikimi në pikat 1.1 deri në 1.12 bëhet përmes të dhënave të pranuar në mënyrë elektronike apo fizike, ose përmes lidhjes së sistemit DMSA-CMS, me sistemet elektronike të institucioneve përkatëse;
4. Përveç verifikimit standard sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij Neni, Agjencia sipas vlerësimit të rrezikut potencial të rrezikut, kryen kontrollin e stilit të jetesës, për qëllim të konsistencës midis informacionit të deklaruar dhe standardit të jetesës së deklaruesit (nëpërmjet vizitave në terren në shtëpinë e tyre, kontrollimit të platformave të mediave sociale si Facebook, Instagram etj. ose ekzaminime të tjera).

## **Neni 8**

### **Rezultati nga kontrolli i plotë**

1. Si rezultat i procedurës nga kontrolli i plotë, kur ka indikacione apo dyshime për pasaktësi apo mospërputhje të deklarimit të pasurisë nga subjekti deklarues, në të dhënat sipas Nenit 3 të kësaj Rregulloreje, zyrtari përgjegjës i kërkon sqarim subjektit deklarues për pasaktësitë e evidentuara nga procesi i verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë së tij të padeklaruar.
2. Pas pranimit të sqarimit nga subjekti deklarues, zyrtari përgjegjës vlerëson dhe rekomandon nëse rasti:
  - 2.1. të mbyllet me raport kur subjekti deklarues arrin të ofrojë prova bindëse që arsyeton pasaktësinë e evidentuar në deklarimin e tij të pasurisë;
  - 2.2. të procedohet me informatë në Prokurorinë e Shtetit ose Policinë e Kosovës, në rastet kur Agjencia ka dyshime për vepër penale, në pamundësi për të siguruar provat e mjaftueshme, ndërsa në Administratën Tatimore të Kosovës, për dyshime për shmangie nga tatimi;
  - 2.3. të procedohet me kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit, kur ka prova të mjaftueshme dhe dyshime të arsyeshme për vepër penale të parashikuar me Kodin Penal të Kosovës;
3. Në rastet e parashikuara në pikën 2.1 të paragrafit 2 të këtij Neni, Agjencia mbyll rastet kur vërtetohet se:
  - 3.1. funksioni i pa deklaruar nuk gjeneron të hyra (rasti mbyllet me qortim publik ose jo publik);
  - 3.2. nuk jeton në bashkësi familjare me subjektin deklarues;
  - 3.3. pasuritë e paluajtshme të pa deklaruar janë nën vlerën 3000 euro;
  - 3.4. pasuritë e luajtshme të pa deklaruar janë nën vlerën 3000 euro;
  - 3.5. vlera e fitimit/dividendendës ose e kapitalit të biznesit ose e aksioneve tregtare, të pa deklaruar është nën vlerën 3000 euro;
  - 3.6. vlera e letrave me vlerë në posedim e të pa deklaruar, është nën 3000 euro;
  - 3.7. kriptovalutat/kriptoasetet në posedim e të pa deklaruar, janë nën vlerën 3000 euro;

- 3.8. vlera e përgjithshme e parave të gatshme është nën 3000 euro;
  - 3.9. të drejtat ose detyrimet financiare pa deklaruar janë nën vlerën 3000 euro;
  - 3.10. donacionet e pa deklaruar në partitë politike janë nën vlerën 3000 euro (rasti mbyllet me qortim publik ose jo publik);
  - 3.11. donacionet ose shpenzimet e padeklaruar janë nën vlerën 3000 euro;
  - 3.12. të hyrat e pa deklaruar për subjektin deklarues, ose për anëtarin e familjes nuk tejkalojnë shumën 3000 euro;
  - 3.13. Janë deklaruar njësi matëse të sipërfaqes ose njësi monetare me gabime teknike si permutacion. (Kjo nënkupton që janë deklaruar njësitë duke ruajtur të njëjtën përmbajtje të shifrave, por duke ndryshuar vetëm rendin;
4. Në rastet kur një subjekt deklarues ka bërë gabime dhe si pasojë ka mospërputhje në deklaram, Agjencia shqipton masë kundërvajtëse qortim publik ose jo publik.
- 4.1 Kur në rastin si në paragrafin 4 subjektit deklarues i shqiptohet qortim publik ose jo publik, dhe nëse gabimi i njëjtë përsëritet nga subjekti deklarues, çështja procedohet në pajtim me paragrafin 2, nën paragrafin 2.3 të këtij Neni.

## **Neni 9**

### **Përfundimi i kontrollit të plotë**

1. Pas përfundimit të kontrollit të plotë, Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, përkatësisht Divizioni për Verifikimin dhe Kontrollin e Pasurisë, përgatit raport përmbledhës për përmbylljen e procesit të kontrollit të plotë.
2. Drejtori i Agjencisë pas pranimit të raportit përmbledhës për kontrollin e plotë aprovon dhe vendos për vendimin final.

## **Neni 10**

### **Papajtueshmëritë e funksioneve nga procesi i kontrollit të plotë**

1. Si rezultat i procesit të kontrollit të plotë, shqyrtimi i konfliktit të interesit të interesave të deklaruar nga subjekti deklarues, në aspekt të papajtueshmërive të funksioneve, bëhet nga Departamenti i Parandalimit të Konfliktit të Interesit, në përputhje me ushtrimin e funksioneve sipas Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.
2. Lista me subjekte deklaruese nga deklarimi i rregullt vjetor, për subjektet deklaruese të cilat ushtrojnë dy ose më shumë funksione/angazhime, përcillet nga Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme, në Departamentin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

3. Lista e kontrollit të plotë për subjektet deklaruese, e cila përfshin të paktën funksionet, të hyrat, pronësinë në biznese apo interesa tjerë, përcillet nga Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave dhe Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme, në Departamentin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për vlerësim dhe shqyrtim të mëtutjeshëm.
4. Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave përcjell edhe përgjigjet nga institucionet tjera ATK, DOJQ dhe ARBK etj, në Departamentin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nëse identifikohen të hyra apo angazhime që nuk janë raportuar fillimisht.
5. Në rastet sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij Neni, ekzistojnë tregues të një konflikti të mundshëm ose aktual interesi, ose të shkeljeve aktuale ose të mundshme të rregullave që rregullojnë papajtueshmëritë e funksioneve sipas ligjit, Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i trajton sipas procedurave të saj të rregullta.

#### **Neni 11**

##### **Mënyra e mbajtjes së dosjeve të kontrollit të plotë**

Të dhënat nga procesi i kontrollit të plotë, duke përfshirë formularin elektronik të deklarimit të pasurisë, raporte, dëshmi, dokumente dhe çdo informacion tjetër në kuadër të procedurës së kontrollit të plotë, ruhen në sistemin elektronik DMSA-CMS.

#### **Neni 12**

##### **Dispozitat përfundimtare**

1. Për çdo çështje e cila nuk është e rregulluar me këtë rregullore, vlejnë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, si dhe dispozitat e Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.
2. Kjo Rregullore mund të rishikohet, të plotësohet apo ndryshohet, varësisht nevojave dhe rrethanave që mund të paraqiten për ndryshim/plotësimin e saj.

#### **Neni 13**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe publikimit në faqen zyrtare të Agjencisë.

#### **YII BULESHKAJ**

---

Drejtore i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit